**AKT THEMELIMI**

**I SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR**

# DR.B.AVDULAJ SHPK

Ne Tirane, sot me dt 30 Janar (dymije e njezete e tre), shtetasja:

Znj. Blerina AVDULAJ, lindur më 22/07/1981 në Patos Fier dhe banues ne Tirane, me kombësi dhe shtetësi shqiptare, mbajtëse e Leternjoftimit me numer 036937988 dhe numer personal I15722051J madhore me zotësi të plotë juridike për të vepruar:

E cila duke u bazuar dhe në përputhje me Ligjin nr.9901, datë 14.04.2008, 'Për tregëtarët dhe shoqëritë tregëtare' , ka vendosur të themelojë një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar (me poshte "Shoqeria"), me dispozitat e mëposhtme.

**Neni 1**
**Emërtimi dhe selia e shoqërise**

Emërtimi i shoqërisë me përgjegjësai të kufizuar është **DR.B.AVDULAJ SH.P.K..**

Selia e shoqërisë ndodhet në eshte : Rruga Ndre Mjeda Pall Star Construction,struktura 1 B/1 kat 8 hyrja 1, Njesia 7 zona kadastrale 8220,Tirane, Shqipëri.Në këtë adrese ndodhet edhe Zyra Qëndrore e Shoqërise.

1.1 Shoqëria mund të hapë degë dhe zyra përfaqësimi brenda dhe jashtë territorit të Rebublikës së Shqipërisë.

**Neni 2**
**Objekti i Shoqërisë**

2.1 Objekti i Shoqërisë është :

Klinike Mjeksore, vizita, trajtim, mikrokirugji dhe kirurgji ORL, Kirurgji Maxillo Faciale, implantologji, angiokirurgji, okulistike, kirurgji e pergjithshme,kirurgji estetike. Ofrimi i sherbimit te konsuleces, ne fushen e otorhinolaringologjise.Import dhe eksport: të paisjeve dhe materialeve mjeksore. Pajisjeve mjekësore, aparatura dhe materiale farmaceutike, lende te para dhe materiale kirurgjikale.
Kurse te çertifikuara pas universitare per mjeke te pergjithshem, estetiste, dhe mjeke orl. Procedura dermoestetike, trajtime dermoestetike, shitje dhe tregtim i produkteve dermoestetike dhe trajnime per procedura dermoestetike. Shitje dhe tregtim aparatesh degjimi dhe asistence teknike per aparatura degjimi.
Kurse te çertifikuara pas universitare per infermiere.Hapje filiale jashte vendit. Shoqeria mundet gjithashtu te zhvilloje te gjitha veprimtarite plotesuese, promocionali dhe te marketingut qe lidhet me sa me siper, perfshire ketu aktivitetet editoriale.
Shoqeria mund te ushtroje aktivitete te shtese, dhe ne funksion te sa me siper si pershembull: organzimi i kurseve te trajnimit dhe konferenca; perpunim i te dhenave elektronike; shperndarje e aparatesh degjimi dhe asistence teknike. Mund te kryeje tregti me shumice dhe pakice, import, eksport, edhe nepermjet Internet-it, dhenien ne perdorim ose qira te pajisjeve dhe produkteve te sektorit shendetesor, duke marre autorizimet e nevojshme.
Shoqeria gjithashtu mund te zoteroje kuota ose pjesmarrje ne shoqeri me aktivitet te ngjashem ose te njejte.Si dhe cdo veprimtari tjeter ekonomike qe do te konsiderohet e nevojshme dhe e dobishme per realizimin qellimit te shoqerise dhe qe nuk bie ndesh me legjislacionin Shqiptar ne fuqi me perjashtim te veprimeve te ndalohen specifikisht nga ligji.

Blerina Avdulaj

Per krverjen e aktivitetit te shoqerise se mesiperme, per te cilin do te nevojitet leje perkatese, shoqeria eshte e detyruar te pajiset paraprakisht me kete leje nga organi kompetent.
Aktivitetin e saj kjo firme mund ta ushtroje si ne Shqiperi ashtu edhe jashte saj
Aktiviteti i shoqerise nuk do te kufizohet vetem ne keto sherbime apo veprimtari

2.2 Shoqëria me qëllim të arritjes së objektivave të përcaktuara mund të bashkëpunojë me direk dhe indirekt me shoqëri të tjera shqiptare ose të huaja që kanë objekt analog osë të lidhur me të tyren.

## Neni 3
## Kohëzgjatja e Shoqërise. Viti ushtrimor

3.1 Shoqëria do të ushtrojë aktivitetin e saj për një afat te pacaktuar.

3.2 Viti i parë financiar do të fillojë nga momenti i regjistrimit të shoqërisë në regjistrin tregëtar, pranë Qëndrës Kombëtare të Biznesit (QKB) Tiranë dhe do të përfundojë në 31 Dhjetor.

3.3 Vitet e mëtejshme financiare fillojnë më 1 Janar dhe përfundojnë me 31 Dhjetor.

## Neni 4
## Kapitali themeltar

4.1 Kapitali themeltar fillestar i shoqërisë është 100.000 Lekë (njeqind mije Lekë) dhe përbëhet tërësisht nga kapital në para. Pjesëmarrja e Ortakeve themelues në kapitalin e shoqërisë është në përputhje me kontributet e tyre të mëposhtme:

4.2 Ortakja e veteme themeluese Z. Blerina AVDULAJ Zoteruese i 1 nje) kuote me vlerë nominale të barabartë prej 100,000 (njeqindmije lek) Lekë që përben 100 % të kapitalit themeltar të shoqërisë.

4.3 Kapitali themeltar perbehet nga 1 (nje) kuote me vlerë nominale të barabartë prej 100,000 (njeqindmije lek) Lekë.

## Neni 5
## Asambleja e Përgjithshme

5.1 Asambleja e përgjithshme është përgjegjëse për marrjen e vendimeve për shoqërinë për cështjet e përcaktuara në Ligjin per Shoqerte tregtare . Asambleja e përgjithshme mblidhet në rastet dhe sipas mënyrës së thirrjes të përcaktuara në statusin e shoqërisë.

## Neni 6
## Administratori

6.1 Shoqëria do të administrohet nga një Adminstrator. Administratori i parë i shoqërisë do të jetë Z. Roven SINANI. Afati i emërimit të Administratorit është 5 vjet, me të drejtë ripërtëritje.

## Neni 7
## Kostot e themelimit

7.1 Të gjitha kostot, pagesat dhe shpenzimet lidhur me themelimin dhe regjistrimin e shoqërisë do të merren përsipër nga shoqëria të cilat do të përfshihen në llogarinë e parë vjetore financiare në shumën e atyre aktuale.

## Neni 8
## Njoftimet

8.1 Njoftimet për oratakët do të kryhen me postë të regjistruar në adresën e kompanise më të fundit të komunikuar nga cdo ortak, me përjashtim kur parashikohet ndryshe nga ligji apo statuti.

8.2 Njoftimi mund të bëhet edhe nëpërmjet postës elektronike, në momentin e krijimit të ksuhteve teknike që kërkohen sipas ligjit.

**Neni 9**
**Dispozita të fundit**

9.1 Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e saj në përputhje me këtë akt themelimi, me statutin e saj dhe ligjin shqiptar.

**Neni 10**
**Kopje**

10.1 Ky akt themelimi hartohet në 3 kopje, sipas këtij destinacioni, nje kopje orataku, një kopje për Qëndrën Kombetare të biznesit dhe një kopjë për zyrën qëndrore të shoqërisë.

**O R T A K U   I V E T E M**

**E SHOQËRISE ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR**

**DR.B.AVDULAJ SH.P.K.**

**BLERINA AVDULAJ**

Bleuina Avdulaj

______________________________________________

Aurela Gjokutaj

Digitally signed by Aurela Gjokutaj
Date: 2023.02.13 23:03:38 +02'00'